



BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-1

297



VIKTOR
QURKU



MOS HARRONI

VJERSHA
E POEMA

8JH-1

R97

VIKTOR QURKU

MOS HARRONI

(vjersha dhe poema)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

UJRAJË 1976

MOS HARËONI

(nizimi dhe shprehja)

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1976

MOJ FAMËMADHE

Shqipëri,
moj famëmadhe,
s'ka rrebesh
të të hedhë,
balli yt
i vetëtitur,
fjala jote
mori dhenë.
Moj e vogël,
një pëllëmbë,
e madhe për socializëm.
Fjalëmbël
me miqtë,
me armiqtë
zjarr e krisëm.
As me topa,
as me tanke,
as me thikë
e bajoneta
trupin dheut
dot s'ta shqitën,
moj e vogëla,
e sërta.

As me lajkëza
prej goje,
as me mallra
tregtarësh,
s'u gënjeve,
s'u dobësove,
s'u lajthite
tradhtarësh.
Për armiqtë
mbete halë,
nëpër shekuj
kockë e fortë,
trimja ti,
moj armëlarë,
vetëtimë
në Evropë.

TË LIRË KUSH E DO VATANIN

Shkëmbinj të thinjur, shkëmbinj
mbi Gjorm, mbi Lepenicë,
mbi Brat,
ushtri e tërë gurësh të mëdhenj
thua do rrokullisen
vrap.

Nga ç'kohë këtu ata mbetën
të palëvizshëm e të shurdhët
mes blegërimave e mes erërave,
mes motorëve e mes grunjërave?

Nga ç'shekull këtu qëndrojnë
të thinjur në shi
e në diej?

Fëmijët posi kuaj i shalojnë
dhe u flasin me zë qiejve.

Të ngjitesha majë malit të dëshirës,
t'i flas Shqipërisë
tej e mbanë:

këta shkëmbinj nuk zbritën në
Shushicë,
përmbi armiq
rrokullimë ranë.

Nga rrokullima e tyre, malit
u bënë përrenj gjer mbi Shushicë,
sepse të lirë kush e do vatanin
dhe malet mbi armiqtë i përmbys.

POEMË PËR BIRÇE SINEMATIN

Te cila ditë të mbahem

e cilën ditë të lë mënjanë,
gjithë ditët e tua — vetëtimë,
more Birçe Sinemati.

Vij të të kërkoj në Kuç

ti në Kallarat e Bolenë ke arritur,
vij në Bolenë te rrapi,
ti zbret kalldrëmit të Gjirokastrës.

Partia pret informata,

ti Kurveleshin i tregon në këmbë,
një më një bien fjalët mbi tavolinë,
një më një dua t'i mbledh.

Po ti më ikën, më shket nga duart,

s'ke kohë, nxiton drejt lirisë,

s'të zë syri i spiunëve ty,

s'të arrin plumbi i fashistëve.

E unë rrekem të mbahem diku,

në oborrin e së fejuarës tënde hyj,
pyes kur do të kthehesh.

*
* *

Ka lënë dyrekun e shtëpisë djegur
e shkon t'u verë flakën katilëve,
ka lënë një dynym tokë pa mbjellur
e shkon të bëhet zot i gjithë dheut,
ka lënë nënën plakë vetëm
e shkon t'u thajë lotët gjithë nënave,
ka lënë te pragu të fejuarën,
e është fejuar me atdheun.
Shikojmë si e kapërcen Bogonicën,
si i përkëdhel me dorë dhe gurët,
duan ta mbërthejnë në Himarë,
në Gjorm del e tund malin,
duan ta shtijnë në dhe në Delvinë,
në Sopot del. u bën varrin.
Hajde ç'vrap i bukur lirie,
hajde ç'pushkë e nxehtë mbi supe,
hajde ç'djem që e ndjekin,
hajde ç'yje mbi gjerdanë.
Ikën behari e vjen dimri,
ai kapton gryka e kapton gjemba,
t'i dinin malet dhimbjet e këmbëve,
do të uleshin, mbi Birçe Sinematin.
T'i dinin fushat gishtërinjtë jashtë,
me bar e lule do të visheshin.

Por ai s'ndalet,
tutje nëpër borë e nëpër plumba,
ulu, Sopot, të shikosh
me një plumb batalionin mbron e s'tundet
uluni male me radhë,
më gjunjë para jush ai ulet,
Zagorie mbahu dhe ca,
t'i shikoj lotët e butë mbi të rënë,
ndalu, Vjosë, mos rridh,
shiko Birçen mes shiut të plumbave.

*
* *

Ku shkon, komisar, ku shkon?
Nata është e zezë dhe e lagësht,
prapa natës, ballistët
me shpirt më të zi se nata prinë.
Kapota qull të kullon nga këmbët,
pse s'kthehesh ta thashë, komisar,
diku te një kasolle e varfër, ta thashë.

*
* *

Prite Kajcë partizane,
prite Kajcë e rrethuar.